



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, pika (d), lidhur me nenin 40, paragrafi 2, pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 28, paragrafi 2 pika (c) dhe 29, paragrafi 2, pika (d) të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 26.03.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me numër të protokollit 01-Nr-016-11550 i datës 11.03.2026 dhe i jepet pëlqimi për ndarjen e mjeteve financiare, në shumën prej 10,000.00 (dhjetë mijë euro), Shoqatës Zona e Pashtrikut.

Neni 2

Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi jepet për arsye të mbështetjes financiare për realizimin e projektit për ngritjen e shtatores së dëshmorit të atdheut, Tahir Sinani, në qytetin e Prizrenit, i cili ka kontribuar në organizimin e njërive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në operacionet luftarake të njërive të UÇK-së, në rrugën e gjatë të përgatitjes për rezistencë të armatosur, ku roli i tij për të përgatitur njësitet për ideal dhe dashuri ndaj atdheut është vlerësuar nga bashkëluftëtarët, nga ushtarakët dhe oficerët e tjerë që iu bashkëngjiten luftës për çlirimin e Kosovës. Tahir Sinani, si një oficer aktiv i Ushtrisë së Republikës së Shqipërisë, mori pjesë drejtpërdrejt në luftën për çlirimin e pjesës së pushtuar të atdheut, duke udhëhequr njësi të ndryshme, për t’u dëshmuar si njëri nga komandantët e shquar të UÇK-së, po ashtu, u bë pjesë edhe në luftën për çlirimin e Kosovës Lindore (UÇPMB), në vitin 2000, si dhe në luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, në vitin 2001.

Neni 3

3.1 Mjetet financiare do të paguhen nga buxheti i Komunës së Suharekës të planifikuara në vitin 2026, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, kodi i programit 21/624/85012/22110/00000/0820 të planifikuar në Drejtorinë për kulturë, rini, sport dhe mërgatë (pagesa për transferet për etnitete publike).

3.2 Mjetet financiare do të lëshohen në xhirollogarinë e përfitues.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Suharekës në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-13486
Me datë 26.03.2026



Kryesuesi i Kuvendit
Mr.ec Bexhet KUÇI